



Shkup, 07/04/2017

Iniciativa e femrave ANTIKO – Shkup, dhe CARE Deutschland/Luxembourg e.V në kuadër të projektit "Përfshirja e grave nga bashkësitë etnike në tregun e punës", financuar nga Bashkimi Evropian bëjnë thirrje:

**THIRRJE PËR ORGANIZIM TË KURSEVE PROFESIONALE NË:
SHKUP, KUMANOVË, TETOVË, MANASTIR, SHTIP**

IQF ANTIKO nga Shkupi bën thirrje organizatave, shoqatave dhe subjekteve të interesuara që ofrojnë shërbime në organizimin e kurseve të paguara dhe të çertifikuara në temat që vijojnë poshtë:

1. Mësimi gjuhëve (anglisht, gjermanisht, maqedonisht);
2. Kurse për parukeri (frizere);
3. Kurse për shminkim (Make Up);
4. Kurse për trajtimtë thonjve (rregullimi, shëndeti dhe mirëmbajtja);
5. Kurse të kosmetikës;
6. Kurse të përkujdesit të posaçëm (persona që kanë nevojë për kujdes të posaçëm);
7. Kurse për kompjuter.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit

Mundësimi i një tregu inkluziv të punës në Maqedoni, ku të gjithë qytetarët, përfshirë edhe ata nga grupet e rrezikuara, të kenë qasje dhe mundësi të barabarta.

Qëllimi specifik i projektit

Rritja e qasjes dhe prania e grave nga bashkësitë etnike në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë, duke forcuar potencialet e tyre për punësim dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm shoqëror/social. Projekti ka paraparë fuqizimin e kapaciteteve të grave nga bashkësitë etnike jo shumicë në Shkup, Tetovë, Manastir, Kumanovë dhe Shtip duke organizuar trajnime dhe orientime profesionale/individuale, me qëllim për të rritur njohuritë dhe kapacitetet e tyre që të jenë sa më konkurruese në tregun e punës

Qëllimi i kurseve të organizuara

Përvetësimi i njohurive profesionale dhe aftësive të vecanta, për të cilat vetë pjesëmarrëset kanë treguar interes dhe dëshirë për pjesëmarrje.





Përshkrimi i detyrave dhe obligimeve të shërbimdhënësit

Cilësia e kurseve

Trajnues profesional me përvojë pune, pajisje profesionale dhe materijale kualitative, sigurimi i kushteve tekniko-hapsinore për trajnim të sigurtë dhe të suksesshëm, organizimi i mësimit teorik dhe punës profesionale-praktike, dhënja e çertifikatave të licencuara-për kursin e kryer të suksesshëm.

Të gjitha pajisjet, mjetet e punës dhe materialet e nevojshme, do të sigurohen nga shërbimdhënësi.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Oferta financiare në denar MKD.-për cdo kurs vecantë;

Emri mbiemri i trajnuesit, kualifikimi profesional (CV e shkurtë);

Vërtetim prej Regjistrisë qendror të R.M. (jo më e vjetër se 6 muaj);

Afati i fundit për dorëzim të ofertës është 17.04.2017 (e hanë). Ofertën mund ta dorëzoni në mynyrrë elektronike në këta adresa contact@antiko.org.mk, antico@t.mk, wci.antiko.mk@gmail.com ose Rr. „Vukovarska“ no.23-1/2, 1000 Shkup, fahun postal 1090-1010. Ofertat mund të dorëzohen dhe ne formë të lirë në memorandum zyrtarë të aplikuesit.

